

**PERMBLEDHJE JOTEKNIKE E RAPORTIT TE
VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS**

PER AKTIVITETIN:

"Shfrytëzim minerali gur gelqeror"

OBJEKTI: "Kodra e Konizbaltes"

(Aktivitet Ekzistues)

Vendodhja: Fshati Konizbalte, Bashkia Ura
Vajgurore, Qarku Berat.

Kërkues: Subjekti: "ARDMIR" Sh.p.k

Hartoi:

"ENVIRONMENTAL MANAGEMENT CONSULTANTS" Sh.p.k

(Çert. Nr. 551 Prot, dt. 24.10.2008)

Administrator

Elidiana Shehu

Mars, 2021

TABELA PËRMBLEDHËSE

1. VENDODHJA.....	3
2. QELLIMI.....	4
3. PERSHKRIMI MJEDISIT.....	5
4. PËRSHKRIMI I PROÇESEVE NDËRTIMORE DHE TEKNOLOGJIKE	9
4.1. Mënyra e shfrytëzimit	9
4.1.1. Përzgjedhja e sistemit të shfrytëzimit të objektit.....	9
4.1.2. Drejtimi i Shfrytëzimit	9
5. IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TE MUNDSHME NEGATIVE NE MJEDISIN KU ZHVILLOHET AKTIVITETI 12	
5.1. Permbledhje e aktivitetit.....	12
5.2. Pershkrimi i ndikimeve te mundshme negative te aktivitetit.....	12

1. VENDODHJA


Sheshi i perzjedhur nga shoqëria për tu shfrytëzuar ndodhet në të djathtë të rrugës së makines Konizbalte — Ura Vajgurore në një distancë rreth 200 m larg në vijë ajrore.

Në Jug të zonës minerare ndodhet fshati konizbalte në një distancë në një vijë ajrore rreth 700 m larg. Zona e lejes ben pjesë në hartat topografike në shkallë 1 :25000 me moniklaturë K-34- 112-D-a (Poshnja)

Objekti gjendet në zonën minerare "Kodra e Konizbaltes", zonë për të cilën shoqëria "ARDMIR" sh.p.k. është shpallur fituese (shkresë nr.7062/1 Prot: MEI dt 07.09.2012 AKT-Miratim nr. 1577. Administrativisht zona në të cilën gjendet karriera egzistuese e zonës minerare, objekti "Kodra e Konizbaltes" përfshihet në territorin e Fshatit Konizbalte, Bashkia Ura Vajgurore, Qarku Berat.

Sipërfaqja e përgjithshme e zonës së liçencuar për shfrytëzim është 0.098 km².

Objekti përfshihet në planshetin topografik 1:25,000 me nomenklaturë K-34-112-D-a dhe kufizohet nga pikat me koordinata si më poshtë:



Në figurën më poshtë tregohen kufijtë e zonës minerare të liçencuar në hartat topografike të shkallëve 1:25,000.

2. QELLIMI

Studimi dhe projekti i hartuar ka për qëllim studimin e mundësisë së vazhdimit të shfrytëzimit të mineralit gure gelqerore në zonen minerare objekti “Kodra e Konizbaltes”, në Bashkinë Ura Vajgurore”, Qarku Berat, nga Shoqëria “**ARDMIR**”, Sh.p.k.

Subjekti “ARDMIR” Sh.p.k per zhvillimin e aktivitetit "Kariere per shfrytezimin e mineralit gure gelqeor (leja minerare, objekti “Kodra e Konizbaltes”) ne zbatim te Ligji nr 10431, date 09.06.2011 “Per mbrojtjen e mjedisit” dhe ndryshimet e tij eshte pajisur me **Leje Mjedisore me nr. 97 Prot, date 18.03.2009, me vendim nr. 4 te Komisionit te lejeve dhe Leje Minerare Shfrytezimi me AKT-Miratim nr. 1577, me nr 7062/1 Prot me date 07.07.2012.**

Referuar formatit te vjeter te lejes Mjedisore (leje mjedisore e vitit 2009), subjekti duke mos aplikuar ne kohe per Rishikimin e kushteve te Lejes Mjedisore, iu nenshtrua si fillim procedures se Njehsimit te lejes se vjeter te mjedisit, ne Miratim Paraprak apo Deklarate Mjedisore. Per te aplikuar me pas per Leje te re Mjedisore.

Agjencia Kombetare e mjedisit miraton Njehsimin e Lejes se Vjeter Mjedisore referuar shkreses me nr 3132/3 Prot, me date 26.11.2018, ku shprehet: **Referuar VKM nr. 419, date 25.06.2014 te ndryshuar, Kreu III "Procedura per shqyrtimin e kerkesave dhe percaktimi i kushteve per leje mjedisi te Tipit B" 2.1 Pika 1 c;) Leja Mjedisore ekzistuese Nr. 97 Prot, date 18.03.2009, te vendimit Nr. 4 i Komisionit te Lejeve per aktivitetin "Shfrytezim guri gelqeror" per objektin "Kodra e Konizbaltes", Ura Vajgurore, Berat eshte e barasvlefshme me Vendimin Paraprak te AKM-se apo te Deklarate Mjedisore te ministrit.**

Por gjate procedures per pajisje me Leje Mjedisore u konstatua se Koordinatat e Lejes Minerare nuk korespondojne me koordinatat e lejes mjedisore te vitit 2009, objekti “Kodra e Konizbaltes”, Ura Vajgurore, Qarku Berat

Persa me siper subjekti “ARDMIR” Sh.p.k po i nenshtrohet edhe njehere procedures se thelluar per vazhdimin e ushtrimit te aktivitetit "Karriere per shfrytezimin e mineralit gur gelqeror (leja minerare objekti “Kodra e Konizbaltes”), referuar legjislacionit aktual per “Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis” te ndryshuar.

Për hartimin e projektit të shfrytëzimit janë marrë në konsideratë:

- Kerkesa per furnizim me lende te pare prane zones se projektit;
- Topografia e zonës së shfrytëzuar ku ndodhet objekti;
- Klima e zonës në të cilën ndodhet objekti;
- Gjendja e infrastrukturës së rajonit dhe zonës së objektit të kërkuar, si dhe mundësitë e përmirësimit të saj;
- Materiali gjeologjik bazë lidhur me ndërtimin gjeologjik të rajonit dhe objektit, sasinë dhe cilësinë e rezervave të gurit gëlqeror;
- Treguesit e ndryshëm fizike, mekanike dhe gjeomekanike të gurit gëlqeror të objektit që do të shfrytëzohet;
- Kërkesa të ndryshme për makineri, pajisje dhe investime të tjera të domosdoshme për vënien në punë dhe shfrytëzimin normal të objektit

3. PERSHKRIMI MJEDISIT

Objekti gjendet në zonën minerare “Kodra e Konizbaltes”, zonë për të cilën shoqëria “**ARDMIR**” sh.p.k. është shpallur fituese (shkresë nr.7062/1 Prot: MEI dt 07.09.2012 AKT- Miratim nr. 1577. Administrativisht zona në të cilën gjendet karriera egzistuese e zones minerare, objekti “Kodra e Konizbaltes” përfshihet në territorin e Fshatit Konizbalte, Njesia Administrative Ura Vajgurore, Bashkia Ura Vajgurore, Qarku Berat.

Zona Gjeografike: Ura Vajgurore kufizohet në veri- perëndim me bashkinë Lushnjë, në veri-lindje me bashkinë Kuçovë, në jug-lindje me bashkinë Berat dhe në jug-perëndim me bashkinë e Roskovecit. Kryeqendra e bashkisë është qyteti i Urës Vajgurore.



Harta e Bashkisë Ura Vajgurore

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011, kjo bashki numëron 27,295 banorë, ndërsa sipas Regjistrimit Civil ajo numëron një popullsi prej 39,551 banorë. Me një sipërfaqe prej 156.56 km², ajo ka densitet prej 174 banorë/km² sipas censurit dhe densitet prej 226 banorë/km² sipas regjistrimit civil.

Kjo bashki përbëhet nga 4 njësi administrative, të cilat janë: **Ura-Vajgurore**, Poshnje, Kutalli dhe Cukalat. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit Berat dhe pjesë e po këtij qarku. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 34 fshatra.

Bashkia e re shtrihet në një zonë të pasur me toka bujqësore shumë pjellore si dhe me burime të rëndësishme guri. Burimet kryesore të të ardhurave për banorët e kësaj zone bazohen te shfrytëzimi i resurseve natyrore, sidomos atyre të përpunimit të inerteve të gurit dhe të lumenjve, i fermave private, përpunimit agro-industrial, plantacioneve me ullinj, dru frutorë dhe vreshta, perimeve, blegtorisë, si dhe përpunimit të produkteve të qumështit dhe mishit.

Kjo zonë është e njohur herët për minierat sipërfaqësore të gurit, ndërsa kohët e fundit edhe për përpunimin e gurit në granit dhe gëlqere, duke u njohur edhe si “gurorja” e Shqipërisë për shkak të numrit të madh të shoqërive private që kryejnë aktivitetet në këtë fushë.

Me ndarjen e re administrative kjo njësi vendore do të marrë një profil të rëndësishëm bujqësor, të orientuar sidomos në frutikulturë me prodhimin e ullirit, por nuk mbetet pas dhe blegtorisë, drithërat dhe perimet, si dhe shumë foragjere. Veçanërisht Komuna Kutalli është e njohur në rang kombëtar për

kultivimin dhe hershmërinë e perimeve në serat pa ngrohje. Këtë mundësi ia jep terreni dhe pozicioni shumë i favorshëm gjeografik që i favorizon fermerët të kultivojnë perime, fruta dhe vreshta. Në fshatrat e komunës, mbi çdo copë toke, janë ndërtuar sera dhe çdo vit nga serat e Kutallisë prodhohen mbi 25 mijë ton perime, ku 80 për qind e tyre eksportohen.

Mjedisi fizik

Gjeologjia

Zona në të cilën zhvillohet aktiviteti gjendet në një strukturë antiklinale të nënzonës së Beratit, që i përket brezit të rrudhosur mbulesor Ionian. Sa i takon kolonës së plotë stratigrafike të zonës ku gjendet territori në studim, nga poshtë – lart, dallohen: Depozitimet më të vjetra në këtë rajon janë ato të Kretakut të Sipërm (Cr2), që përbëjnë krahët dhe kulmin e strukturës së rrudhosur. Këto depozitime përfaqësohen nga gëlqerorë shtresorë deri në masivë të alternuar me gëlqerorë mikritikë me shtresëzim të dobët. Ata kanë trashësi mbi 370 m.

Mbi Depozitimet e Kretakut të sipërm, shtrihen normalisht ato të Paleocenit (Pg1), të përbërë nga gëlqerorë turbiditike, gëlqerorë masivë me ndërfaqe shtresore të gëlqerorëve shtresëhollë. Trashësia e depozitimeve të Paleocenit varion nga 100 m deri në 120 m. Në të gjithë zonën, në krahët e strukturave të rrudhosura, shtrihen depozitimet e Eocenit (Pg2). Prerja përbëhet nga gëlqerorë turbiditike, që kalojnë në gëlqerorë shtresore biomikritikë e mikritikë, të pasuar nga mergele argjilore. Trashësia e tyre arrin në rreth 200 m.

Në krahët e strukturave të rrudhosura takohen gjithashtu depozitimet e Oligocenit të poshtëm (Pg31) dhe Oligocenit të mesëm (Pg3 2). Vërehet kalimi nga formacioni flishoidal në atë mergelor të pakos kalimtare. Depozitimet e Oligocenit të poshtëm janë rreth 840 m të trasha ndërsa ato të oligocenit të mesëm rreth 700 m. Depozitimet e Oligocenit të sipërm (Pg3 3) kanë përhapje të kufizuar në krahasim me ato të Oligocenit të poshtëm dhe të mesëm dhe takohen në rrudha si ndërfaqe të ranorëve argjilo-aleuolitike me ranorë masivë dhe me shtresa të rralla gëlqerori. Depozitimet e Oligocenit të sipërm kanë trashësi rreth 1140m. Sedimentet e Kuaternarit përbëhen nga proluvionet (guraleca argjilore pjesërisht të rrumbullakosura) dhe nga deluvionet (brekçie karbonatike), të cilat janë shumë të përhapura në shpatet e maleve.

Sizmiciteti

Zona është vendosur në sistemin e thyerjeve reversibile me rënie midis V-JL dhe VVP-JJL të zonave sizmogenike Adriatike dhe Jonike, dhe ngjitur me zonën sizmogenike Lushnje- Elbasan-Dibër.

Në këtë territor mund të bien tërmete me Mmax të pritshme midis 6.0 dhe 6.9 (Aliaj, 2004). Sipas Hartës së Sizmicitetit të Shqipërisë ky territor përdhëhet në Zonën e Shkallës VIII të MSK-64, të shkallës së intensitetit sizmik.

Gjeomorfologjia

Nga pikpamja e shtrirjes gjeografike, siperfaqja e njesise ku ndodhet karriera kufizohet në lindje, veri dhe veriperëndim nga rrjedha e poshtme e Devollit, në jugperëndim (ku gjendet edhe zona e propozuar

për zhvillimin e aktivitetit) nga rrjedha e poshtme e Osumit dhe në jug shërben si kufi Qafa e Dardhës që e ndan nga Tomorri.

Objekti gjendet rreth 9.5 km vijë ajrore në veriperëndim të Beratit dhe shtrihet ndërmjet kuotave +40 dhe +160 m mbi nivelin e detit.

Sa i takon morfologjisë, ky rajon përfaqëson një reliev kodrinor me organizim të çrregullt, në të cilin vend të rëndësishëm zenë luginat e përrrenjve që e përçajnë atë në drejtime të ndryshme.

Territori i propozuar për zhvillimin e aktivitetit shtrihet në tarracat lumore të krijuara nga rrjedha e poshtme e Osumit. Lugina e Osumit është në një stad pjekurie. Karakteristike, ashtu si edhe për disa lumenj të tjerë të vendit tonë, është zhvillimi i tarracave dhe zallishtores kryesisht në anën e djathtë të lumit. Ky fenomen duhet të ketë lidhje me pozicionin e shtratit të lumit (nga e majta) përkundrejt strukturës sinklinale të Poliçanit.

Tokat

Në zonën ku gjendet objekti i propozuar për zhvillimin e aktivitetit dallohen Tokat Livadhore Aluvionale dhe ato Livadhore të Hinjta Kafe.

Tokat Livadhore Aluvionale janë të formuara mbi depozitimet proluviale të Kuarternarit dhe takohen kryesisht shumë pranë brigjeve të Osumit. Ato janë të formuara nga depozitime të materialeve të trasha si zaje, gurë, zhavorr dhe rërë në të dy krahët e rrjedhës së lumit. Këto toka kanë profil pak të zhvilluar dhe me karakter të theksuar shtresor. Në pjesët e buta dhe me bimësi diferencohet horizonti A dhe profili i tokave është A-C. Aftësi ujëmbajtëse e tyre është e vogël. Ndonëse ujërat nëntokësorë nuk janë shumë thellë, ato nuk arrijnë të ushqejnë shtresat e sipërme pasi ngjitja kapilare e tyre është e pamundur. Kjo është arsyeja që përgjithësisht gjatë verës këto toka janë të thata. Janë toka me përmbajtje të ulët të elementëve ushqyes, ndërsa përmbajtja humusit varion nga 0.15-0.4% në sipërfaqe në 0.1% në thellësi. Moshë relative e tokave aluvionale është krahasimisht më e vogël se e llojeve të tjera të tokave. Këto toka janë të përshtatshme për të gjitha bimët bujqësore por, vetëm nëse trajtohen me kujdes veçanërisht në drejtim të prishjes së kores dhe vlerave biologjike që ajo përmban, si dhe, nëse evitohen depozitimet e reja të lumenjve.

Tokat Livadhore të Hinjta Kafe janë të përhapura në të gjithë zonën fushore bregdetare të vendit, ku përfshihet edhe rajoni në studim. Ato krijohen mbi depozitime aluviale dhe deluviale, në kushte të nivelit të lartë të ujërave nëntokësorë, i cili ndikon në zhvillimin e bimësisë livadhore. Prandaj edhe procesi pedogjenetik i formimit të tyre dominohet nga procesi i livadhëzimit (prej nga vjen edhe emri Livadhore të Hinjta Kafe). Ato kanë profil të diferencuar dhe ngjyrë që ndryshon nga e hinjtë e errët (në sipërfaqe) në të hinjtë të verdhë (në thellësi). Përbërja varion nga argjilore në subargjilore. Në horizontet e poshtme gjenden akumulime karbonatesh (CaCO_3). Për nga cilësitë kimike, këto toka paraqiten neutrale në reaksion, të pasura në carbonate kalciumi, mesatare në azot, fosfor dhe humus. Sa i takon përmbajtjes së elementëve lehtësisht të asimilueshëm nga bimët, këto toka paraqiten mesatarisht të varfëra në fosfor dhe të pasura në kalium.

Ujërat

Zona e propozuar për zhvillimin e aktivitetit gjendet shumë afër rrjedhës së poshtme të lumit Osum, i cili rrjedh rreth 1.5 km në perëndim të saj. Osumi përfaqëson edhe burimin ujqor sipërfaqësor më të

RAPORT TEKNIK

rëndësishëm në zonë. Ai është degë kryesore e Semanit, është 161 km l gjatë, ka një sipërfaqe ujëmbledhëse prej 2'150 km², lartësia mesatare 828 m, prurje mesatare shumëvjeçare 32, 5 m³/s dhe rrjedhje të pakta prej 17,5 l/s/km². Uji ka mineralizim mesatar prej 345 mg/l.

Osumi është një ndër lumenjtë kryesorë të Krahinës Malore Jugore. Prurja e tij pëson luhatje të theksuara gjatë vitit dhe për nga sasia e prurjes së lëngët ai renditet ndër lumenjtë mesatarë të vendit.

Klima

Zona në të cilën gjendet objekti ku propozohet të zhvillohet aktiviteti përfshihet në pjesën qendrore të Zonës së Klimës Mesdhetare Fushore.

Kjo zonë përfshin të gjithë pjesën e ulët dhe bregdetare të Shqipërisë dhe karakterizohet nga regjim klimatik i tipik mesdhetar. Reshjet më të mëdha bien gjatë stinës së vjeshtës dhe të dimrit, kryesisht në formë shiu. Dëbora është një dukuri e rallë dhe e papërfillshme. Në këtë zonë vrojtohen mesatarisht 2550.0-2850.0 orë me diell, temperatura mesatare vjetore luhatet 15.0-16.00C, temperatura mesatare e muajit janar, i cili është muaji më i ftohtë i vitit, luhatet në kufijtë 8-10 0C, ndërsa temperatura e muajit gusht, i cili është më i nxehti, në kufijtë 24-26 0C. Sasia mesatare e reshjeve vjetore luhatet në kufijtë 1000.0 – 1200.0 mm, ndërsa numri i ditëve me reshje >1.0 mm luhatet 85-100 ditë. Drejtimi dominant i erës është ai l veriperëndimit, ndërsa shpejtësia mesatare 2.0 – 3.5 m/s.

4. PËRSHKRIMI I PROÇESEVE NDËRTIMORE DHE TEKNOLOGJIKE

4.1. Mënyra e shfrytëzimit

4.1.1. Përzgjedhja e sistemit të shfrytëzimit të objektit

Për të përcaktuar mënyrën e shfrytëzimit u morën në konsideratë këta elementë:

- topografia e zonës së projektit,
- sasia e rezervave të shfrytëzueshme,
- karakteristikat gjeomekanike të shkëmbinjve,
- elementët e shtruarjes dhe koeficienti i zbulimit.

Nga analiza e këtyre faktorëve është përzgjedhur si më i përshtatshëm shfrytëzimi me qiell të hapur i objektit.

Gjithashtu, shfrytëzimi me karrierë i gurit gëlqeror në objektin favorizohet dhe nga:

- Rënia e formacioneve që ndërtojnë pakon produktive, në drejtim të tillë që lejojnë zhvillimin normal të shkallëve dhe elemeteve të tyre pa sjellë kushtëzime teknike.
- Eksperienca e shfrytëzimit në objekte të njëjta, e cila ka treguar se elementët e shtruarjes së formacioneve të gurit gëlqeror dhe karakteristikat gjeomekanike të tyre favorizojnë këndet deri 75° të skarpatave dhe nuk sjellin asnjë rrezik rrëshqitje.
- Hidrografia e zonës në përgjithësi dhe territori i projektuar për lejen minerare në veçanti. Sipërfaqja është plotësisht e drenuar dhe nuk ka probleme ujërash dhe burimesh të pranishme në të, për rrjedhojë nuk pritet të krijojë probleme për shfrytëzimin e vendburimit.
- Koeficienti i zbulimit në masën e pakonsiderueshme, në sajë të të cilit nuk ka nevojë për sipërfaqe të depozitimit të përhershëm ose të përkohshëm të sterileve. Për pasojë, i gjithë aktiviteti do të kryhet në kufijtë e lejes minerare dhe nuk do të ketë kërkesa për shtesë sipërfaqe ose ndryshim kufijsh të sipërfaqes së lejes.

4.1.2. Drejtimi i Shfrytëzimit

Drejtimi i përgjithshëm i shfrytëzimit do të vazhdojë të jetë i kombinuar nga lart poshtë, nga poshtë lart dhe nga qendra për në kufi në shkallët e përkohshme me sipër të harmonizuara me njëra tjetrën për kryerjen e transportit të brendshme si dhe ngarkimit dhe transportit të materialit të prodhuar për tu cuar, sipas kërkesave dhe programit të parashikuar të zhvillimit të punimeve të shfrytëzimit, ku do të shitet produkti i prodhuar .

Në tabelën e mëposhtme jepet realizimi i pritshëm i prodhimit të gurit gëlqeror (brekcije të shpatit) i ndarë në 3 muaj në shkallë, në zonën midis profileve I-I ,II-II dhe III-III .

Në profilet përkatëse, të përmendura me sipër dhe në planimetri janë pasqyruar levizjet e parashikuara në shkallë për realizimin e prodhimit për periudhën në vazhdim



Pamje te shfrytezimit te karrieres

Mënyrat e rrëzimit të ngurit gëlqeror në karrierë

Formacionet gëlqerore që do të shfrytëzohen për prodhimin e gurit gëlqeror janë të forta, prandaj për rrëzimin dhe copëtimin e tyre do të përdoren lëndë plasëse të vendosura në bira sonde.

Copëtimi i shkëmbit në karrierë është projektuar të bëhet me këto metoda:

- Me matrapik të vendosur në eskavator,
- Me lëndë plasëse të vendosur në bira sonde.

Copëtimi me matrapik do të përdoret kryesisht për thyerjen e copave të mëdha të gurit gëlqeror, hapjen e rrugëve të karrierës, punimet përgatitore, shesheve të punës etj.

Sistemi i shfrytezimit.

Ne realizimin e volumit të punës si me sipër, do të përdoret shfrytezimi me qiell të hapur. Sistemi i shfrytezimit që do të vazhdojë të përdoret edhe për vitet në vazhdim, do të përdoret sistemi i shfrytezimit me transport automobilistik dhe me depozitim të mbetjeve minerare në sheshet e planifikuar për ruajtjen e trajtimin e tyre sipas kërkesave ligjore. Në zgjedhjen e sistemit të shfrytezimit janë marrë parasysh faktorët e mëposhtëm:

Eksperiencia e deritanishme në zbatimin e sistemit të shfrytezimit,

Kushtet tekniko-minerare të objektit;

Menyra e ngarkimit, transportit dhe depozitimit të sterilit të zbulimit;

Menyra e kryerjes së punimeve të zbulimit;

Menyra e ngarkimit dhe transportit të gurit gëlqeror në brendësi të karrierës dhe jashtë saj;

Mjetet e ngarkimit dhe transportit që parashikohen të përdoren në zbulim dhe prodhim;

Menyrën e rrëzimit dhe shkeputjes së gurit gëlqeror;

RAPORT TEKNIK

Ngarkimi i gurit gelqeror ne sheshet e shkalleve te shfrytezimit, behet dhe parashikohet te behet me fadroma dhe eskavatore me kove te variushme 1.5 -2 m³.

Transporti i sterilit te zbulimit dhe gurit gelqeror parashikohet te behet me kamiona (dumber) 30 ton.

Sterilet e zbulimit do te depozitohen brenda kufijve te zones se shfrytezimit ne zonen e caktuar per kete qellim nen kuoten +105 m.

Bazuar ne sa me siper, sistemi i shfrytezimit qe parashikohet te perdoret eshte i thjeshte me transport te sterilit ne distance deri 1.5 km, duke lejuar ne kete menyre depozitim e tij brenda karrieres dhe jashte saj.

Sterilet e depozituar, te perzgjedhura me pare, do te perdoren pjeserisht per mbulimin e siperfaqes se shfrytezuar ne vitet e fundit te ushtrimit te aktivitetit. Ato do te ridepozitohen ne sheshet brenda karrieres per ti paraprire rigjenerimit te mjedisit.

Kapaciteti Prodhues;

Prodhimi i gurit gëlqeror nga shfrytëzimi i objektit Konisbalte do të ketë si destinacion përdorimin si material inert në fushen e ndertimit. Në varësi të volumit të parashikuar të punimeve për këtë projekt, subjekti parashikon një prodhim vjetor prej rreth 100,000 m³/vit .

Veprimtaria minerare e shfrytezimit gjate gjithë periudhes fillestare te lejes minerare sipas projektit te zhvillimit te veprimtarise minerare do te realizoje:

Prodhim gelqerori ne total	2 200 000 m ³
Prodhim minerali ne vit	100 000 m ³

5. IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TE MUNDSHME NEGATIVE NE MJEDISIN KU ZHVILLOHET AKTIVITETI

5.1. Permbledhje e aktivitetit

Karriera sipërfaqesore e gurit gelqeror ne zonen minerare objekti “Kodra e Konizbaltes”, eshte karriere egzistuese e shfrytezuar me pare nga vete subjekti ARDMIR shpk i cili zoteron lejen minerare me afat 25 vjecar. Subjekti e shfrytezon zonen minerare prej viti 2012.

Si rrjedhim jane kryer te gjitha punimet e zbulimit te mineralit dhe largimit te pjese vegjetale te shtreses se sipërme te tokes. Gjithashtu pjesa me e madhe e sasise se mineralit te gurit gelqeror parashikur ne projektin teknik fillestar eshte nxjerre.

Referuar lejes minerare per shfrytezimin e gurit gelqeror te vendburimit “Kodra e Konizbaltes”, subjekt ka aftesi per vazhdimin e punimeve per nxjerrjen e mineralit deri ne vitin 2037. Kapaciteti vjetor i prodhimit te gurit gelqeror; 100 000 m³/vit.

Referuar kjo edhe sasise se pergjithshme te rezervave te vendburimit Hamalloj, 2 200 000 m³ mineral gure gelqeror.

Persa me siper nuk do te kemi operacione zbulimi dhe si rrjedhim nuk do te kemi edhe gjenerim te dherave, sterileve apo pjesa vegjetale. Nuk kemi ndikime pasi kjo faze (faza e zbulimit) eshte ezauruar ne fillim te shfrytezimit te kesaj zone minerare.

5.2. Pershkrimi i ndikimeve te mundshme negative te aktivitetit

- Ndikimi më i rëndësishëm që rrjedh nga zbatimi i projektit është ndryshimi i destinacionit të përdorimit të tokës. (peisazhit) Sipërfaqja e përgjithshme e ndikuar është 0.098 km².
- Po kaq është edhe sipërfaqja e tokës e cila parashikohet të dëmtohet nga ana strukturore si pasojë e zbatimit të projektit.
- Gjithashtu si rezultat i aktivitetit të propozuar do të ndodhë shqetësim i faunes prane sipërfaqes se shfrytëzimit. Ndikimi në cilësitë agronomike të tokës do të dëmtojë potencialin e saj për mbirjen e bimësisë dhe për këtë arsye do të nevojiten masa rigjeneruese gjatë zbatimit të projektit. Subjekti gjate kohes se shfrytezimit ka investuar ne mbjelljen e siperfaqes jashte karrieres me ulinj dhe drure frutore .
- Për shkak të përbërjes dhe morfologjisë zona minerare është e ekspozuar ndaj erozionit. Aktiviteti që zhvillohet në të, mund të shkaktojë rritje të shkallës së erozionit. Erozioni dhe lëvizja e grimcave shkëmbore jashtë objektit, që do të thotë ushtrimi i ndikimit të tyre jashtë kufijve të objektit. Pjerrësia e terrenit bëhet shkak që grimcat e tokës të ekspozohen ndaj agentëve atmosferikë duke u shkëputur dhe lëvizur jashtë zonës së shfrytëzimit. Erozioni do të kontrollohet përmes masave të parashkuara në Planin e Menaxhimit.
- Një tjetër ndikim i mundshëm është humbje e pjerrësisë së tokës në skarpitetet e shkallëve të karrierës. Sipërfaqja tjetër e mbetur nga shfrytëzimi do të jetë horizontale dhe pas rehabilitimit do të ketë kushte të mira.
- Si pasojë e përdorimit të mekanikës dhe makinerive në presion hidraulik mund të shkaktojë ndotje të tokës me lubrifikante dhe lëndë ndotëse.

RAPORT TEKNIK

- Duke qenë se të gjitha mjetet dhe makineritë që do të përdoren në karrierë janë me motor me djegie të brendshme, cilësia e ajrit ka të ngjarë të ndikohet si pasojë e shkarkimeve në mjedis të gazeve të djegies NOx dhe SOx, por ndotja e ajrit do të jetë e shpërndarë dhe e pakonsiderueshme. Kjo ndotje nuk do të ndikojë në cilësinë e ajrit në zonën e projektit.
- Nga ana tjetër vetë natyra e aktivitetit të propozuar dhe mënyra e zgjedhur për shfrytëzim, janë shkak i gjenerimit të zhurmave dhe një sasi pluhuri, i cili do të jetë më i ndjeshëm në stinën e thatë. Me zbatimin e praktikave më të mira të menaxhimit do të parandalohen edhe ndikimet në shëndetin e punëtorëve.
- Njëkohësisht avaritë e mekanikës mund të bëhen shkak për rrjedhje lubrifikantësh dhe karburantesh, të cilët nën veprimin e ujrave të shiut mund të shkaktojnë ndotje të ujërave sipërfaqësorë dhe nëntokësorë.
- Sasia e mbuleses bimore, dherave nga carjet shkembore që do të dalin do të depozitohen brenda sipërfaqes se karrieres, për tu përdorur me vone për rehabilitimin e saj. Bimesia e shkullur, të ruhet dhe të përdoret në fund për rehabilitimin e zonës.
- Këto ndikime janë të pashmangshme por masat për zbutjen e tyre mund të rezultojnë të suksesshme në fazën e rehabilitimit. Këto masa do të mund të zbatohen me më tepër efikasitet gjatë vitit të ardhshme të shfrytëzimit mbasi të jete vijuar me rehabilitimin progresiv dhe duhet verejtur sjellja e biodiversitetit në objekt.
- Ndër ndikimet më evidente do të jenë ndryshimet në pjerrësinë e terrenit dhe ato vizuale të pejsazhit. Gjithashtu ndikime do të ketë edhe në zhvillimin e proceseve të tokëformimit etj. në sipërfaqen e prekur.
- Gjenerim i mbetjeve urbane nga aktiviteti njerëzor: kartona, bidona vaji, ambalazhe dhe qese plastike nga ambalazhet dhe aktiviteti i punonjësve.
- Aksidente të mundshme të punonjësve gjatë proceseve teknologjike në objekt, veçanërisht gjatë kryerjes së shpërthimeve.

Mënjanimi i këtyre rreziqeve varet shumë nga masat që do të parashikohen dhe zbatohen në Planin e Menaxhimit.